




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.
Nr. f. pag. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
03	01-4057/12 08.11.2012
PRISHTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.10.2012, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-2423/12, për Zyrtarin e Lartë, z. Daut Haradinaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dëshmuar se ka shkëputur kontratën e punës si këshilltarë në kompaninë private “ERC.Trade”.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-2423/12, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z. Daut Haradinaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka qenë duke punuar edhe si Këshilltar i jashtëm në kompaninë private “ERC.Trade” e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 14.08.2012, e ka njoftuar

zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z. Daut Haradinaj, ka komunikuar me zyrtarët e Agjencisë dhe e ka konfirmuar se e ka marr shkresën njoftuese dhe dëshiron të njoftohet me detal për situatën që dyshohet për Konflikt të mundshëm të Interesit.

Pas kërkesës që ka pasur zyrtari i lartë z. Daut Haradinaj, për tu takuar që të informohet me detalisht me faktet që posedon Agjencia, zyrtarët e AKK-së kanë qenë në takim dhe e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia.

Gjate takimit e kemi njoftuar z. Daut Haradinaj, se për cilën situatë bëhet fjalë, ndërsa ai, është shprehur i gatshëm për bashkëpunim, por na ka njoftuar se për çështjen në fjale lidhur me ushtrimin e funksionit si Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe angazhimit në veprimtari private si Këshilltar i jashtëm në kompaninë private "ERC.Trade" nuk ka njohuri se mund të ketë Konflikt të Interesit, por ka theksuar se nëse Agjencia e konstaton se ushtrimi i veprimtarisë si këshilltar i jashtëm në kompaninë private "ERC.Trade" ka mos pajtueshmëri me funksionin e Deputetit, menjëherë do të shkëput kontratën e punës me këtë kompani dhe nuk do të vazhdoj që të ushtroj me atë.

Zyrtarët e Agjencisë e kanë njoftuar z. Haradinaj se ligji Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, e kufizon Zyrtarin e lartë se gjatë ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë nuk ka të drejtë të ushtroj veprimtari private si: (këshilltar në kompani private), andaj ushtrimi i veprimtarisë private paraqet mos pajtueshmëri në Ushtrimin e Funksionit Publik dhe duhet që të shmanget nga kjo situatë.

Zyrtari i lartë, z. Daut Haradinaj, pasi është bindur për këtë është zotuar se në afatin më të shkurtër do të bëjë shkëputjen e kontratës me kompaninë private "ERC.Trade" dhe do ta njoftojë Agjencinë.

Me datën 17.10.2012, z. Daut Haradinaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka njoftuar Agjencinë me shkrim se ka ndërpre kontratën dhe nuk gjendet në marrëdhënie pune dhe nuk ushtron më funksionin si Këshilltar në kompaninë private "ERC.Trade" Prishtine

Andaj në bazë të dëshmive dhe fakteve konstatohet se :

Zyrtari i lartë, z. Daut Haradinaj, ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej pasi që ka dhënë dorëheqje nga pozita e Këshilltarit në kompaninë private "ERC.Trade" Prishtine, dhe mbetet vetëm në funksionin e Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si Deputet i Kuvendit të Republikës dhe Këshilltar i jashtëm në kompaninë private "ERC.Trade".

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:


- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>Z-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-4055/12</u>
Dep.	Prot No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>08.11.2012</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.10.2012, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I.** Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-3465/12, për **z. Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes** për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK–03-3465/12 që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes, ku është dyshuar për konflikt të interesit në ushtrimin e Funkcionit Publik si Kryetar i Komunës së Shtimes dhe angazhimit të tij në veprimtari tjera private si Ligjërues në një Universitet Privat.

Pas analizimit të gjendjes është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit, pasi që z. Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes, nuk bie në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrim e funksionit publik pasi që neni 10.2 i po këtij ligji e lejon që zyrtari i lartë të ushtroj punë nga lëmi i arsimit nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera.

Andaj duke vlerësuar gjendjen faktike konstatohet se nuk ka elemente që dëshmojnë gjendjen e Konfliktit të Interesit, pasi që zyrtari i lartë z.Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes nuk gjendet në situatën konfliktit të interesit sepse angazhimi i tij, si mësimdhënës nuk paraqet mos

pajtueshmëri në ushtrimin funksionit publik, të parapare sipas ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:


- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit





REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Z-D/DPK	Nr Prot.	01-4053/12
Dep.		Br Prot.	
Nr. I faq.	02	Data	08.11.2012
Broj stranica		Datum	
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **05.11.2012**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-4798/11, për ztr. *Halit Krasniqi* – Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4798-11, për Zyrtarin e lartë, ztr. Halit Krasniqi – Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në një biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit, konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, ztr.Krasniqi, është paraqitur, në takim me zyrtaret e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas kësaj bisede, zyrtari i lartë, ztr. Halit Krasniqi ka deklaruar se do të filloj procedurat e ndryshimit të kësaj gjendje, konform Ligjit për parandalimin e konflikti të interesit, në ushtrimin e funksionit publik.

Meqense ky ndryshim ka zgjatur, atëherë Agjencioni kundër korrupsionit, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarit te larte i ka dërguar edhe shkresën e dytë.

Pas shkresës së dytë nga Agjencia (Z.D./DPK-01-3133/12), që ndryshe quhet Paralajmërim, zyrtari i lartë, ztr.Krasniqi, ka bërë ndryshimet e nevojshme duke u tërhequr nga funksioni i personit të autorizuar dhe menaxhues në ndërmarrjen private, dhe duke vazhduar ta kryej vetëm funksionin e vet publik si Deputet në Kuvendin e Kosovës.

Për ndryshimet e bëra në këtë biznes, Agjencinë kundër Korrupsionit, ka nxjerr informacion zyrtar nga ARBK-ja, me informacionet e reja mbi biznesin "Drenari" (DPK/DPKI-03-3955/12), në të cilat shihet se ai, tashmë, nuk ushtron funksion menaxhues në këtë biznes.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, dhe Ligjit për parandalimin e konflikti të interesit (Nr.04/L-051) , kemi konstatuar se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)


Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni





REPublika e Kosoves/REPublika Kosova/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep.	2-0/DPK	Nr. Prot. Br. Prot.	01-4051/12
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	02	Data Datum Date	08.11.2012
PRISHTINE			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **02.11.2012**, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2441/12, për ztr. Arben Loshi – Drejtor i Prokurimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, për shkak se është parandaluar situata me konflikt interesi në të cilën mund të ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-2441-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Arben Loshi – Drejtor i Prokurimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ), është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në një biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit, konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, ztr.Loshi, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.



Pas kësaj bisede, zyrtari i lartë, ztr. Arben Loshi, ka deklaruar se ai biznes nuk është fare aktiv, por megjithate ai, konform ligjit, menjehere ka filluar procedurat për parandalimin e konflikti të mundshëm të interesit.

Për ndryshimet e bëra në këtë biznes, ztr.Loshi, me datën 01.11.2012, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellur dokumentin zyrtar nga ARBK-ja(DPK.DPKI-03-3936/12), me informacionet e reja mbi biznesin; "Beni Keramik", në të cilat shihet se ai, tashmë, në mënyrë vullnetare e ka shuar në tërsi këtë biznes.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, dhe Ligjit për parandalimin e konflikti të interesit (Nr.04/L-051) , kemi konstatuar se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

